



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal of Kacanik

01 Nr. 07-104/02-22361/24  
Kaçanik, 30.09.2024

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, të nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transport Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/13 Qershor 2013), të nenit 34.5 lidhur me nenit 6.2 të Statutit të Komunës, nenit 5, pika 1.2 e Rregullores për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut 01Nr. 07-344-32032/14, me Propozim të drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave në konsultim me Kryetarin e Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 30 shtator 2024, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMUNAL PËR TRANSPORT LOKAL PUBLIK**  
**TË UDHËTARËVE 2024-2028**

1. Me këtë Vendim, MIRATOHET Plani Komunal për Transport Publik të Udhëtarëve 2024-2028, me numër të protokollit 01 Nr. 07-104/02-22361/24.
2. Plani Komunal për Transport Publik të Udhëtarëve (PKTPU) është një dokument udhëzues dhe planifikues, i cili mundëson zbatimin e politikës kombëtare të transportit të udhëtarëve në nivel komunal, orientimin strategjik të komunës së Kaçanikut drejt një menaxhimi të qëndrueshëm të transportit publik të udhëtarëve.
3. Plani Komunal për Transport Publik të Udhëtarëve si në pikën 1. të këtij vendimi është hartuar nga grupi punues, i përmbledhur në 46 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdesen: Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave dhe Inspektorati komunal.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** Kryetari i Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë (përmes kësaj drejtorie njoftohen mekanizmat tjerë relevantë), Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseki

